



Prishtinë: 30.04.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_245\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_372\_03\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_372\_03\_10** ;
5. Apeli i konsumatorit me datë 07.04.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; dhe
7. Rregullën për shkycje dhe rikycje të konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2010, nxori këtë:**

#### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Dardan Bllacaku (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 90028749) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 05.01.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 03.11.2010 lidhur me kontestimin e njoftimit për shkycje dhe shkyçjes.

- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar njoftimin për shkycje dhe shkyçjen nga ana e KEK-ut  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 03.11.2009 Departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se njoftimet për shkycje dhe shkyçjet kanë arritur si rezultat i borxhit të energjisë elektrike ndaj ndërmarrjes së energjisë.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 03.12.2009
- Me datë 09.09.2005, KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkycje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 320.31 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit

- Me datë 10.10.2005, punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 57.50€. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 14.08.2009 konsumatori Dardan Bllacaku ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumatorë për anulimin e dënimit për shkyçje që iu është bërë nga ana e KEK-ut. **Provë:** Kërkesa e konsumatorit e protokolluar në KEK me datë 12.01.2007
- Me datë 03.11.2009 Departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar si të pabazë. **Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 03.11.2009
- Me datë 05.01.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 19.03.2010 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë një vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se njoftimi për shkyçje dhe shkyçjet janë bërë sipas Rregullës për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë. **Provë:** Vendimi i DMK në ZRRE me datë 19.03.2010
- Me datë 07.04.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_372\_03\_10. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në Bord të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_372\_03\_10 dhe ka vërejtur se KEK-u nuk e ka arritur të vërtetojë se a ka dërguar njoftimin për shkyçje apo jo te konsumatori. Sipas transaksioneve të konsumatorit shihet se konsumatori edhe pas njoftimit për shkyçje ka bërë një pagesë të energjisë elektrike ku ka zvogëluar borxhin e energjisë elektrike. Bordi i ZRRE-së në bazë të analizave të cekura më lartë, **pranon** ankesën e konsumatorit dhe kërkon nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga njoftimi për shkyçje i datës 09.09.2005 dhe shërbimi i shkyçjes i datës 10.10.2005.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar